

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: “I RI” sh.p.k sh.p.k, me NIPT L71726018M, me adresë: Rr. “Dervish Hima”, Nr. 8, NjB 2, Tiranë dhe “Hydro & Energy” me NIPT K72227008T, me adresë: Rruga e Kavajes, Kompleksi "Parku Lana", Kati i 2 – të, Tiranë, me kryesuese shoqërinë “I RI” sh.p.k.

Procedura e prokurimit: **“Shërbim Konsulence”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Projektim për objektin: “Vazhdimi i Shëtitores së Vlorës - Segmenti jugor nga fushat e sportit deri tek tuneli”.

Numri i referencës së procedurës: REF-13719-03-15-2019

Fondi limit: 14,078,834 (katërmëdhjetëmilion e shtatëdhjetë e tetëmijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 03.04.2019.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës me paraqitjen e shprehjeve të interesit në këtë procedurë shoqëritë si më poshtë:

Nr.	Shoqëria
1.	A&E Engineering sh.p.k.
2.	J.V. "I RI" sh.p.k. dhe "Hydro Energy" shpk,
3.	J.V. Instituti Dekliada - Alb& CEC Group
4.	J.V. PNI - 2001 & GK & UTS - 01
5.	J.V. Sphaerash.p.k. & Klodioda
6.	J.V. "ICE" shpk" dhe "Mediterranea Enginnering " shpk
7.	Land & Co sh.p.k.

Pas vleresimit të dokumentacionit të paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Të skualifikojë Operatorin Ekonomik "Land & CO " shpk për arsye se:
 - Nuk ka numrin e punonjesve të kërkuar për periudhën Shkurt 2018- Shkurt 2019, në kundërshtim me kërkesën 2.3.2 për kualifikim ku, ndër të tjera citohet: *"Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 18 punonjës .*
 - Nuk plotëson kërkesën për kualifikim lidhur me licencat e kërkuara për projektim mungon pika (4 i) në kundërshtim me kërkesën 2.3.4.ku citohet se *Operatori Ekonomik duhet të disponoj licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës bazuar në formatin e miratuar.*
2. Të skualifikojë bashkimin e Operatoreve Ekonomik "Sphaera" shpk dhe "Klodioda" për arsye se nuk ka paraqitur *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 4/1 pjesë perberese e DST .*
 Gjithashtu bashkimi i operatoreve në fjalë nuk ka plotësuar *Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të Përgjithshme* në formatin e kërkuar në DST ku mungon paragrafi:
Personi/at në cilesinë e anëtarit të organit administrativ ,drejtuesit ose mbikëqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimarrje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ etj
Nuk janë ose kanë qenë të denuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të percaktuara në nenin 45/1 LPP
3. Të skualifikojë bashkimin e Operatoreve Ekonomik "G&KStudio" shpk "PNI 2001" shpk dhe "UTS 1" shpk. për arsye se nuk ka paraqitur *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 4/1 pjesë perberese e DST .*
 Po kështu bashkimi i operatoreve në fjalë nuk ka plotësuar *Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të Përgjithshme* në formatin e kërkuar në DST ku mungon paragrafi:
Personi/at në cilesinë e anëtarit të organit administrativ ,drejtuesit ose mbikëqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimarrje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ etj
Nuk janë ose kanë qenë të denuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të percaktuara në nenin 45/1 LPP

4. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomik “ICE”shpk dhe “Mediterranea Enginnering ” shpk. per arsye se nuk ka paraqitur *Deklaraten per paraqitje oferte te pavarur sipas shtojces 4/1 pjese perberese e DST .*
Gjithashtu bashkimi i operatoreve ne fjale nuk ka plotesuar *Deklaraten mbi permbushjen e kriterëve te Pergjithshme* ne formatin e kerkuar ne DST ku mungon paragrafi:
Personi/at ne cilesine e anetarit te organit administrativ ,drejtuesit ose mbikeqyresit,aksionerit ose ortakut,ose ka kompetenca perfaqesuese,vendimarrje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si me poshte:_____ etj
Nuk jane ose kane qene te denuar me vendim gjyqesor te formes se prere per asnje nga veprat penale, te percaktuara ne nenin 45/1 LPP.
5. Të konsiderojë të kualifikuar bashkimin e shoqërive “I RI” dhe “Hydro Energy” shpk, të cilët i plotësojnë kërkesat për kualifikim.
6. Të konsiderojë të kualifikuar bashkimin e shoqërive “Instituti Dekliada - Alb” dhe “CEC Group” shpk. të cilët i plotësojnë kërkesat për kualifikim.
7. Të konsiderojë të kualifikuar bashkimin e shoqërive “A& Engineering” shpk dhe “UTS - 01” shpk. të cilët i plotësojnë kërkesat për kualifikim.

Në fazën e dytë, (fazën e propozimeve teknike) paraqiten propozim Bashkimi i operatorëve ekonomikë “I RI” shpk & “Hydro Energy” shpk dhe operatori ekonomik “A&E Engineering” shpk.

Vlerat e ofertuara pas hapjes se propozimeve financiare ishin si me poshtë:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “I RI” shpk & “Hydro Energy” shpk paraqiti ofertë për realizimin e projektit në shumën 14.006.000 (katërmëdhjetë milion e gjashtëmijë) Lekë, pa TVSH ose 16.807.200 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatë mijë e dyqind) Lekë, me TVSH dhe u vlerësua në total me 97.67 pikë.

Operatori Ekonomik “A&E Engineering” shpk paraqiti ofertë për realizimin e projektit në shumën 13.500.000 (tremëdhjetë milion e pesëqindë mijë) Lekë, pa TVSH ose 16.200.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind mijë) Lekë, me TVSH dhe u vlerësua në total me 88.00 pikë.

Duke i'u referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: “I RI” sh.p.ksh.p.k. me NIPT L71726018M, me adresë: Rr. “Dervish Hima”, Nr. 8, NjB 2, Tiranë dhe “Hydro & Energy”sh.p.k.me NIPT K72227008T, me adresë: Rruga e Kavajes, Kompleksi "Parku Lana", Kati i 2 – të, Tiranë, me kryesueseshoqërinë “I RI” sh.p.k., se oferta e paraqitur nga ana juaj, me vlerë 14.006.000 (katërmëdhjetë milion e gjashtëmijë) Lekë, pa TVSH, vlerësuar me 97.67 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor:Fondi Shqiptar i Zhvillimit Rr. “Sami Frashëri”, nr. 10, Tirana, Albania, Phone: 00355 42 235 597/8 (int. 151) Fax: 00355 42 234 885, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brënda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.05.2019.

Ankesa: Për procedurën nuk janë paraqitur ankesa.